



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.21.02.2022, (e hënë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit komunal
4. Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.-I-36, e dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit
5. Plotësim ndryshimi i Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën e Obiliqit
6. Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja e Komitetit,

Vlora Mjekiqi Kabashi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILIÇIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREKTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Iziznos

Nr. 1-24
Br.

Data 15-02-2020
Ratim

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.01.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiçi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Nazlije Shala, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana dhe Linda Sadiku

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiçi, Nënkryetar i Komunës, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, drejtorët komunal dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiçi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Formimi i Komisionit komunal për hartimin e planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2022
3. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve në lagjen "Hade e Re"
4. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022
5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për formimin e KKSBB-së
6. Plotësim ndryshimi i vendimeve:
 - a) Vendimi nr.-I-102, i dt.04.08.2021
 - b) Vendimi nr.-I-67, i dt.25.04.2019

4. Shqyrtimi i kërkesave

5. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 4 vota për, 2 vota kundër, ndërsa një anëtar nuk mori pjesë fare në votim.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja – Kuvendi komunal harton planin e punës, miraton planin e punës dhe raportin vjetor të Komunës sipas LVL-së, neni 40.2, alinea 2, që janë një ndër kompetencat themelore të Kuvendit komunal. Plani i punës parashehë aktivitete për punën e Kuvendit komunal dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa. Unë propozoj që Komisioni për hartimin e planit të punës të Kuvendit komunal të përbëhet prej 3 anëtarëve.

Enver Gashi – Propozon z.Labinot Mirena, anëtar të Komisionit.

Sami Ahmeti – Propozon znj.Ajshe Haliti Pllana, anëtare e Komisionit.

Linda Sadiku – Propozon z.Bajram Hashani, anëtar të Komisionit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal formimin e Komisionit komunal për hartimin e planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2022.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DPUKP-së, për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve në lagjen "Hade e Re".

Arben Berisha – Komisioni i cili do të formohet duhet të përbëhet edhe nga Ekzekutivi, duke pasë parasysh se Drejtoria i prin procesit në bazë të praktikës së kaluar, por në Komision duhet të jenë edhe anëtarët e Kuvendit. Unë sugjeroj se në Komision është mirë të jenë anëtarë të zonave që marrin pjesë dhe e kanë prejardhjen prej tyre. Propozoj që Komisioni të përbëhet prej 5, ose 7 anëtarëve, do të thotë 2 anëtarë të jenë nga Ekzekutivi dhe 3 nga Kuvendi, apo ju si e parashihni. Edhe ligji e parashehë se Ekzekutivi duhet ti prij proceseve për arsye se ne jemi në procese. Komisioni ka për qëllim takimin me lagjen, me qytetarët atje në të gjitha pjesët ku ne nuk kemi rrugë dhe i sjellim prapë në Kuvend, që të vendosë Kuvendi pranimin ose kthimin prapa të propozimeve që merren nga qytetarët. Ne me propozimin e qytetarëve e formojmë listën rezervë dhe i emërtojmë rrugët.

Enver Gashi – Propozon z.Lulzim Preniqi, anëtar të Komisionit.

Sami Ahmeti – Ne realisht nuk kemi asnjë propozim për këtë Komision vetëm shpresojmë se nuk do të vazhdojnë me praktikën e kaluar që me vazhdue dhe me lënë emërime të personave politikë, por gjithsesi të shkohet me toponime apo diçka që i lidhë të gjithë qytetarët.

Ibush Mjekiqi – Tash vetëm duhet ti rekomndohet Kuvendit komunal, ndërsa në mbledhjen e radhës në Kuvend jepen emrat dhe po ashtu, edhe Ekzekutivi i sjellë emrat. Procedurat e emërimit janë standarde ose ka me qenë figurë politike, ose toponime të vendit, pastaj është çështje e Kuvendit të vendosë për ose kundër. Unë nuk them se është bërë praktikë e gabuar, por nëse ka pasë lëshime ose mungesë në procedura ne jemi këtu, që ti përmirësojmë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesën e DPUKP-së, për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve në lagjen “Hade e Re”.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Zarife Behluli – Ne e kemi bërë kërkesën në bazë të rregullave të Departamentit të tatimit të pronë dhe këtu i kemi normat tatimore që janë minimale, që janë për njësitë bujqësore të parcelave, për njësitë bujqësore të objekteve, për njësitë pyjore të parcelave, për njësitë rezidenciale të parcelave, për njësitë rezidenciale të objekteve që është 0.15 %. Ndërsa njësitë komerciale të parcelave dhe njësitë komerciale të objekteve është norma tatimore 25 %, pjesa e fundit njësitë industriale të parcelave dhe njësitë industriale të objekteve janë 0.30 %.

Sami Ahmeti – Realisht ky nuk është një propozim i ri, do të thotë është vazhdimësi e propozimeve që janë bërë të paktën në 2 vitet e fundit, megjithatë duke pasë parasysh pandeminë, krizën ekonomike, rritjen e çmimeve, këto skema në këtë vit ne kishim propozue që këto të zbriten të paktën për 0.5 %.

Enver Gashi – Ne jemi për propozimin e dhënë nga DEFZH-ja..

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit komunal, kërkesën e DEFZH-së për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e Kryetarit për formimin e KKSB-së.

Ibush Mjekiqi – Është një Komision standard dhe sipas Udhëzimit Administrativ në mbledhjen e radhës të Kuvendit, do ti keni emrat se kush duhet të jetë aty.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe me 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal formimin e KKSB-së, sipas kërkesës së Kryetarit nr.-II-27, të dt.20.01.2022

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti plotësim ndryshimin e vendimeve: a) vendimin nr.-I-102, të dt.04.08.2021 dhe b) vendimin nr.-I-67, të dt.25.04.2019. Ky plotësim ndryshim i vendimeve duhet patjetër të bëhet për arsye të ndryshimit të Ekzekutivit dhe legjislativit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe me 2 vota abstenim ia rekomanduan

Kuvendit komunal plotësim ndryshimin e vendimeve: a) vendimin nr.-I-102, të dt.04.08.2021 dhe b) vendimin nr.-I-67, të dt.25.04.2019.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Enver Bicolli lidhur me emërtimin e rrugës në fshatin Mazgit i Lartë. Mendoj se kjo kërkesë duhet ti dërgohet DPUKP-së, për shqyrtim dhe në mbledhjen e Kuvendit të na sjellë përgjegjen.

Ibush Mjekiqi – Pasi që jemi duke e formuar Komisionin për emërtimin e rrugëve, atëherë kjo mbetet në procedurë e sipër.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe me 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal kërkesën nga Enver Bicolli, për emërtimin e rrugës në fshatin Mazgit i Lartë.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit komunal për formimin e Komitetit për komunitete sipas kërkesës së MAPL-së.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal rishqyrtimin e vendimit nr.-I-3, të dt.24.12.2021, sipas kërkesës së MAPL-së, nr.VI-020-984/6, i dt.18.01.2022.

Sami Ahmeti – Duke pasë parasysh gjendjen me pandemi që e kemi dhe disa nga shkollat veç kanë fillue të mbyllen, ne propozojmë që në mbledhjen e radhës drejtori i Arsimit të na jepë një raport të përgjithshëm për gjendjen e të infektuarve si dhe për gjendjen e shkollave të cilat janë mbyllë.

Ibush Mjekiqi – Gjendja është e rënduar në kohën e fundit jo vetëm në Komunën tonë, por në nivel të vendit. Sa i përket raportit drejtori i Arsimit në mbledhjen e radhës gjithsesi do ta sjellë. Ndërsa gjendja e shkollave momentalisht është e tillë se nuk ka vendim për mbyllje të shkollave, por është një rekomandim i Ministrisë së Arsimit, që nëse infektohen më shumë se 5 % të personelit dhe nxënësve, atëherë duhet të shkohet me skenarë të tjerë. Ne do ta përcjellim situatën në mënyrë të vazhdueshme dhe do të veprojmë konform situatës e cila na paraqitet.

Kryesuesja – Pra, mbetet që drejtori i Arsimit në mbledhjen e radhës të na sjellë një raport dhe të na informoj më detalisht lidhur me rastin dhe gjendjen nëpër shkolla.

Mbledhja përfundoi në ora 10:34'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesja e KPF


Vlora Mjekiqi Kabashi